



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201600164/4

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandohet revokimi i veprimeve përbarimore për vjeljen e detyrimit në të holla nga të ardhurat e siguruar si ndihmë për mundësimin e trajtimit mjekësor.*

Drejtuar : **Jordisa Dervishi, përbaruese gjyqësore**
Adresa : Bulev "Zogu I", Rruga "Maliq Muço",
barimit

TIRANË

Për dijani : **Ylli Manjani**
Ministër i Drejtësisë

Tedi Malaveci,
Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përbaruesve
Gjyqësor Privat.

TIRANË

L.A
Adresa :

FIER

Zj/Znj. Përbaruese gjyqësore,

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka pranuar për shqyrtim ankesën e shtetases Luaneta Aliaj, në të cilën ajo ka prezantuar shqetësimin e kryerjes nga ana juaj të veprimeve përbarimore mbi të ardhurat mujore të përfituara si rimbursim nga Spitali Rajonal, Fier, për ekzekutimin e detyrueshëm të Titullit Ekzekutiv, Akt-marrje kredie bankare nr.C-9017, datë 17.06.2005, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Vendimin nr.189, datë 15.02.2006, me objekt ; "Shlyerje kredie" prej debitorëve solidar, bashkëshortët A dhe L.A.

Nga aktet e vëna në dispozicion prej ankueses, rezulton se, ju zj/znj. Përbaruese Gjyqësore, me rastin e kalimit të afatit për dorëzimin në mënyrë vullnetare të detyrimit, keni kryer veprime përbarimore për vendosjen e masës së sekuestrës mbi llogarinë e debitorit A.A. në "Raiffeisen BANK", me shkresën nr.02104, datë 14.01.2016, dhe më

te j keni urdhëruar me shkresën nr. 04088 prot, datë 27.01.2016, transferimin e shumës prej 22.447 lekë nga llogaria e debitorit në llogarinë tuaj për t'ia paguar palës kreditore.

Referuar Shkresës nr.1964/1 prot, datë 22.01.2016, të "Raiffeisen BANK", drejtuar Shoqërisë Përmbaremore "STAR" Sh.p.k. dhe juve zj/znj Përmbareuse Gjyqësore, rezulton se, jeni venë në dijeni se të ardhurat e krijuar prej debitorit në llogarinë e tij pranë "Raiffeisen BANK", janë siguruar si kreditime të përnuajshme me përshkrimin "Dializë".

Pala debitore, shprehet se, ka mundësuar informimin tuaj rreth origjinës së krijimit të shumës në të holla të sekuestruar, gjatë takimit të zhvilluar para 10 apo 15 ditësh në banesën e tij, të ndodhur në Levan, Fier. Rezulton se shuma në të holla është krijuar si disbursim i Spitalit Rajonal, Fier, në mbështetje të mundësimit të kurimit të debitorit për sëmundjen që ai vuan. Heqja nga posedimi i shumës ë të holla prej 22.447 lekë, passjell vështirësi deri në pamundësi të vijimit të kurimit nga ana e debitorit pranë Spitalit Rajonal, Fier.

Debitori në komunikimin e kryer me nëpunësin e Institucionit të Avokatit të Popullit është shprehur se, në çdo dy ditë, me të ardhurat e disbursuara nga Spitali Rajonal, Fier, (me destinacion; pagesë transporti për pacientin nga banesa në Spitalin Rajonal, Fier), mundëson shkuarjen pranë Spitalit Rajonal, Fier, për kryerjen e mjekimit të nevojshëm për mbijetesë.

Ndodhur në situatën e lartpërmendur, për të cilën besojmë se jeni informuar, veprimtaria për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të lartpërmendur, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, duhet të zhvillohet duke vendosur për refuzimin e kryerjes së veprimeve përmbaremore për sekuestrimin e të ardhurave të krijuar prej debitorit si ndihmë për mundësimin e kurimit shëndetësor të tij. Arsyetimi i këtij qëndrimi të mund të kryhet nga ana juaj në mbështetje të nenit 21 të Kushtetutës, si dhe nenit 2 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me Ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore".

Për arsyen e bërë të ditur, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin thuhet se : "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike", si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, i cili parashikon se : "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen",

REKOMANDOJMË

Revokimi i veprimeve përmbaremore për vjeljen e detyrimit në të holla nga të ardhurat e siguruara si ndihmë për mundësimin e trajtimit, mjekimit shëndetësor të debitorit A.A.

Refuzimin i kryerjes së veprimeve përmbaremore mbi të ardhurat e çelura debitorit për trajtimin shëndetësor të tij.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Etilda GJONAJ(SALIU)

Konceptoi dhe Daktiligrafoi
A.Gjoleka